



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.01.2024

Nr: 05

Ora: 10:45

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 03, DATË 08.01.2024 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI "PARTIA G99"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.01.2024, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Partia G99, me kryetar z. Redi Shtino

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021".

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21 pika 1 shkronja "b", 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



## VËREN:

Subjekti "Partia G99", ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 03 regj., datë 08.01.2024.

Në mbledhjen e datës 12.01.2024, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 03, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja "a", të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve", kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja "a" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, KAS-i

## V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 03, datë 08.01.2024, të paraqitur nga subjekti "Partia G99".
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 12.02.2024, ora 12:00

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës "b", të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>Lako</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>Çefa</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>